



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME
SH.A.UJESJELLES – KANALIZIME
LIBRAZHD-PRRENJAS

VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHËSHME TË SHOQËRISË
UK-LIBRAZHD SH.A

NR. 03 DATË 29/05/2023

Sot, më datë 29 Maj 2023, Shoqëria UK-Librashd, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J68122606V mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Agron Gega, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Çështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Shkarkimin e Administratorit
- Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria UK-Librashd nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 4307 Rep. dhe Nr. 2331 Kol, datë 12.10.2022 midis shoqërisë UK-Librashd dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 1.1.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja vendosi:

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Shkarkimin e Z. Agron Gega si Administrator të shoqërisë U-K Librazhd sha.
- (4) Emërimin e Z. Erdis Alikaj si likuidator të shoqërisë nga data 01/06/2023 .
- (5) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u sigurua se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

KRYETAR

Kastriot GURRA

Nuri BELBA